VENDIM
Nr. 82, datë 6.2.2026

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES, ELEMENTEVE TË REGJISTRIT KOMBËTAR TË INSTITUCIONEVE, INSTITUTEVE, NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE TË KËRKUESVE SHKENCORË, PROCEDURAVE TË KRIJIMIT TË TIJ, E TË ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT, SI DHE TË DOKUMENTACIONIT QË DEPOZITOHET PËR REGJISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e formës, përmbajtjes, elementeve të Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe të Kërkuesve Shkencorë (në vijim "regjistri"), procedurave të krijimit të tij, e të administrimit të informacionit, si dhe të dokumentacionit që depozitohet për regjistrim.

2. Regjistri krijohet mbi bazën e të dhënave të institucioneve, instituteve, njësive të veçanta të kërkimit shkencor dhe të kërkuesve shkencorë të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

II. FORMA, PËRMBAJTJA DHE ELEMENTET E REGJISTRIT

1. Regjistri mbahet në formë elektronike dhe përbëhet nga ndarje të veçanta (module) për çdo kategori të organizimit të institucioneve të kërkimit shkencor dhe të kërkuesve shkencorë, subjekte publike dhe jopublike, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", si më poshtë vijon:

a) Ndarja A (moduli A) për institucionet e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas ligjeve të posaçme;

b) Ndarja B (moduli B) për institutet kërkimore;

c) Ndarja C (moduli C) për njësitë e veçanta;

ç) Ndarja Ç (moduli Ç) për kërkuesit shkencorë.

2. Regjistri përmban të dhënat kryesore administrative të institucioneve, instituteve, njësive të veçanta të kërkimit shkencor, si dhe të dhëna të kërkuesve shkencorë dhe veprimtarisë së tyre.

3. Regjistri për personat juridikë, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij kreu, përmban elementet, si më poshtë vijon:

a) emrin e subjektit dhe shkurtimin e emrit;

b) formën juridike;

c) aktin dhe datën e krijimit;

ç) numrin e regjistrimit;

d) adresën e selisë dhe vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

dh) kontaktet e subjektit;

e) objektin e veprimtarisë;

ë) fushat kërkimore;

f) burimet e financimit;

g) drejtuesin e subjektit;

gj) akreditimin, nëse është subjekt i akreditimit;

h) strukturën organizative dhe personelin;

i) elementet për projektet, si vijon:

i. emërtimin;

ii. qëllimin;

iii. kohëzgjatjen;

iv. financuesit;

v. partnerët.

4. Regjistri për kërkuesit shkencorë, sipas shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij kreu, përmban të dhëna identifikuese dhe profesionale për individët, që angazhohen në veprimtari kërkimore-shkencore, si më poshtë vijon:

a) të dhëna personale;

b) kategorinë e punonjësit kërkimor-shkencor;

c) gradën shkencore dhe titullin akademik;

ç) institucionin ku ushtrohet veprimtaria kërkimore-shkencore;

d) fushat kërkimore dhe ekspertizën;

dh) produktet shkencore (artikuj, monografi, libra, pjesëmarrje në konferenca, patenta, vlerësime për arritje shkencore ndërkombëtare).

III. PROCEDURAT E KRIJIMIT, ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT TË REGJISTRAVE

1. Regjistri elektronik krijohet dhe administrohet sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi për krijimin e bazave të të dhënave shtetërore.

2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në cilësinë e institucionit administrues të regjistrit, miraton rregulloren për administrimin e regjistrit, e cila përmban normat tekniko-metodologjike të regjistrimit e të verifikimit të informacionit të dhënë nga institucionet, institutet, njësitë e veçanta dhe kërkuesit shkencorë për regjistrim.

3. Kërkesa për regjistrimin e institucioneve, instituteve, njësive të veçanta të kërkimit shkencor dhe të kërkuesve shkencorë bëhet nëpërmjet portalit "*e-Albania*" me dokumentacionin, sipas kreut IV, të këtij vendimi.

4. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit bën vlerësimin administrativ të dokumentacionit, brenda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe dokumentacionit, nëpërmjet portalit "*e-Albania*". Nëse pas vlerësimit rezulton se dokumentacioni nuk është i plotë, i kthehet përgjigje subjektit për të bërë plotësimet e nevojshme, brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh punë nga marrja e njoftimit. Nëse dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, kërkesa për regjistrim refuzohet. Nëse dokumentacioni është i plotë, institucioni ose kërkuesi shkencor regjistrohet në regjistër dhe merr numrin e regjistrimit.

5. Çdo institucion, institut dhe njësi e veçantë e kërkimit shkencor dhe kërkues shkencor, që regjistrohet për herë të parë, ashtu si dhe në vijim, ka detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim, sa herë që ka të tilla në të dhënat e regjistrimit fillestar dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër.

6. Dokumentet shoqëruese, si për regjistrimin për herë të parë ashtu edhe për përditësimin e të dhënave në regjistër, depozitohen nëpërmjet portalit "*e-Albania*", në përputhje me mënyrën e përcaktuar në rregulloren për administrimin e regjistrit.

7. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e informacionit dhe e të dhënave të gjeneruara, si rezultat i procedurave të regjistrimit, kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat, mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtat e autorit dhe bazat e të dhënave shtetërore.

IV. DOKUMENTACIONI QË DEPOZITOHET PËR REGJISTRIM NË REGJISTËR

1. Dokumentacioni që depozitohet për regjistrim për herë të parë në regjistër të institucioneve, instituteve dhe njësive të veçanta nëpërmjet portalit "*e-Albania*" është, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacioni administrativ:

i. akti i krijimit ose akti ekuivalent me atë të krijimit;

ii. statuti, kur këto janë dy dokumente të veçanta;

iii. rregulloret e brendshme;

iv. burimet e financimit;

v. dokumenti i akreditimit, nëse është subjekt i akreditimit.

b) Dokumentacioni për projektet në proces, ku të përfshihen të paktën titulli i projektit, fushat e kërkimit, qëllimi, shuma e projektit, financuesit, kohëzgjatja, partnerët;

c) Dokumentacioni për personelin, ku të përfshihen lista e punonjësve kërkimorë-shkencorë të specifikuar sipas kategorive, kualifikimet e tyre dhe fushat e ekspertizës;

ç) Dokumentacioni për publikimet dhe patentat, në rast se ka, si botimet në revista shkencore të vendit e të huaja dhe format e tjera të pronësisë intelektuale, si patentat dhe format e tjera të pronësisë industriale.

2. Dokumentacioni që depozitohet nëpërmjet portalit "*e-Albania*" për regjistrimin e kërkuesve shkencorë është, si më poshtë vijon:

a) Curriculum vitae (CV);

b) dokumentacioni për kategorinë e kërkimit shkencor që zotëron;

c) diplomat dhe certifikatat akademike;

ç) vërtetimi nga institucioni ku punon (nëse ka);

d) deklarata personale për fushën e kërkimit;

dh) certifikata e gjuhës së huaj;

e) dokumentacioni për publikimet dhe patentat, në rast se ka, si botimet në revista shkencore të vendit e të huaja e format e tjera të pronësisë intelektuale dhe format e tjera të pronësisë industriale.

3. Për përditësimin e të dhënave në regjistër, depozitohet dokumentacioni nëpërmjet portalit "*e-Albania*", që vërteton përditësimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Procedura e aplikimit, sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit "*e-Albania*", zbatohet pasi ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe kërkimit shkencor të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemin Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).

2. Kërkesat dhe procedurat administrative për regjistrimin në regjistër, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) dhe në vijim, trajtohen dhe zhvillohen nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit në regjistrin në formë fizike (të shkruar). Të dhënat e mbajtura në këtë regjistër, me përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemin Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS), plotësohen në këtë sistem nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, institucionet, institutet, njësitë e veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesit shkencorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama